

Revista e cila merret me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

ON LINE

në 6 gjuhë në website
www.lpkosova.com.

Mirë se erdhët në botën tone

DONATORET QE NDIHMUAN DALJEN E KËTI NUMRI FESTIV U
UROJNË VITIN E RI 2010!



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

SOROS

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo
Kosovo Foundation for Open Society



Republika e Kosovës
Ministria e Punës dhe
Mirëqenies Sociale



Intervistë me Avokatin e Popullit, Sami Kurteshi

- Z.Kurteshi, sa janë të mbrojtur me ligj personat me aftësi të kufizuara?

Edhe përkundër faktit se në Republikën e Kosovës ekziston një kornizë ligjore për Personat me Aftësi të Kufizuara, dhe megjithë veprimet e ndërmarra nga institucionet shtetërore, kjo kategori e personave janë në gjendje shumë të rëndë, kurse integrimi i tyre në shoqëri është shumë i mangët.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, dhe sidomos Ligji kundër diskriminimit, u garanton të gjithë qytetarëve, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues në të gjitha sferat e jetës. Nëse ana normative është pika e ndritshme, mangësitë e dëshmuara në jetën e përditshme fillojnë me miratimin e ligjeve dhe sidomos të akteve nënligjore në këtë fushë, që kanë të bëjnë me zbatimin e normave ligjore në jetën praktike.

-Z.Kurteshi, a ka ankesa nga ana e qytetarëve dhe të cfarë natyre janë ato?

Bazuar në ankesat e parashtruara në Institucionin e Avokatit të Popullit, fatkeqësisht duhet konstatuar se implementimi i kornizës ligjore për personat me aftësi të kufizuara, është krejt i pakënaqshëm, i pamjaftueshëm dhe diskriminues. Kjo shprehet në të gjitha sferat e jetës.

Edhe pse lëvizja e lirë e personave me aftësi të kufizuara garantohet, nuk zbatohet aspak. Përveç një përpjekjeje gjysmake në kryeqytetin e Kosovës, për rregullimin e infrastrukturës rrugore, infrastruktura tjetër, sidomos ajo nëpër institucionet publike në Kosovë, nuk e plotësojnë asnjë standard vendës, e aq më pak ndërkombëtar.

Në fushën e arsimit këta persona janë krejtësisht të diskriminuar. Përveç disa shkollave speciale publike për disa kategori të pakta të këtyre personave, ku sigurohen disa kushte elementare, infrastruktura në shkollat e Kosovës është krejtësisht e papërshtatshme, fatkeqësisht kanë mbetur apo edhe do të mbeten analfabetë.

Megjithëse këta persona janë të liruar nga pagesat për shërbime shëndetësore, ata detyrohen që vetë t'i sigurojnë medikamentet e nevojshme, edhe pse të gjithë

janë me nevoja speciale, shumica nuk janë të punësuar, e madje shumë nga ta nuk gëzojnë as të drejtën në pensione për persona me aftësi të kufizuara.

Sfera e punësimit për persona me aftësi të kufizuara vazhdon të mbetet pa perspektivë. Edhe më tej Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ndërmerr masat e mundshme dhe të domosdoshme, për të zhvilluar shërbime të specializuara për trajnime profesionale.

Përveç diskriminimit nga institucionet publike në aspektin e informimit, për shkak të mungesës së përkthyesve në gjuhën e shenjave, këta persona janë të diskriminuar edhe nga mjetet e informimit publik, për shkak të mospërshtatshmërisë së nevojshme për nevojat e kësaj kategorie të qytetarëve.

Po aq shqetësues është edhe fakti se familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara, nuk gëzojnë përkrahje materiale nga ana e institucioneve përgjegjëse, megjithëse Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligjin për përkrahje materiale. Moszbatimi i këtij ligji dëshmon për humnerën e madhe që ekziston midis kornizës moderne ligjore dhe realitetit të hidhur kosovar, qoftë edhe me arsyetimin e mungesës së buxhetit.

-Z.Kurteshi, si mund të përmisohet gjendja aktuale?

Është obligim i të gjitha institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, e sidomos i Qeverisë së Kosovës, të angazhohen seriozisht për zbatimin e ligjeve të miratuara. Ky është obligim i institucioneve ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kurse Institucioni i Avokatit të Popullit, në kuadër të mandatit dhe kompetencave kushtetuese dhe ligjore që ka, edhe në të ardhmen nuk do të pushojë që të kërkojë respektimin e ligjeve dhe zbatimin e tyre në jetën e përditshme.



“ QASJE PËR TË GJITHË “

ME RASTIN E SHËNIMIT TË DMD-SË

POST MORTUM

LIGJI I RI

PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA I REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2009-2011

Foto EKSPOZITE
"EDHE NE JEMI KETU"

Në kuadër të konferencës për promovimin e Planit Aksional Kombëtar të njëjtën ditë u organizua në Teatrin Kombëtar, një Foto Ekspozitë me crast u ekspozuan punimet e organizatave të ndryshme të cilat përfaqsojnë personat me aftësi të kufizuara. Organizatore ishte Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Italian Cooperation - Ministria e punëve të jashtme të Italisë.




Poashtu u organizua një punëtori e cila kishte për qëllim të analizoj të arriturat kryesore në implementimin e planit aksional nacional dhe të përforcoj bashkpunimin ndërmjet pjesmavesve, për të aritur rezultate sa më të mira në vitin 2010.

Analiza e Punës

02. dhjetor 2009 në Prishtinë u mbajtë një puntori në të cilën u analizuan të arriturat kryesore në implementimin e Planit Nacional për personat me aftësi të kufizuara. Poashtu u tha se duhet përcaktuar se cilat sfida na presin në të ardhmen dhe se si të shtrohet koordinimi i programit dhe projektit për, Planin e punës për vitin 2010.

Qeveria e Kosovës me vendim barti kompetencat e saja mbi Zyrën e Qeverisë për Qeverisje të Mirë, të drejtat e njeriut dhe mundësi të barabarta për hartimin e planit aksional nacional. Në bazë të kompetencave, kjo zyrë morri përsipër të përpunoj, dhe koordinoj bashkpunimin me institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal, me ekspert ndërkombëtar, dhe me OJQ-të të cilat mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Qeveria pasi miratoi këtë plan, morri vendim që për hirë të transparencës dhe informimit sa më cilësor mbi proceset që do të zhvillohen të organizoj një Konferencë për promovimin e planit nacional

Ky plan jo vetëm që pati efektin simbolik, ngase për herë të parë në Kosovë u miratua një dokument i këtij karakteri, por tani e tutje do të shërbejë si udhërefyes për punën tonë të mëtutjeshme në përmisimin e kualitetit jetësor për personat me aftësi të kufizuara në RK.



POST MORTUM

Halit Ferizi

Ndërroi jetë më 5 maj 2009

Për Halit Ferizin – udhëheqësin shpirtëror të personave me aftësi të kufizuara!



Në këtë jetë ka njerëz që dorëzohen para rrebesheve të jetës dhe ka të tillë që i sfidojnë ato. Ka të atillë që u përshtaten rrymave të jetës dhe ka të atillë që ua ndërrojnë kahun atyre. Ka të lirë që jetojnë të nënshtruar dhe të robëruar që luftojnë për të qenë të lirë. Ka të atillë që vetëm kërkojnë lirinë, barazinë dhe emancipimin, por ka edhe të tillë që luftojnë për to dhe në luftë e sipër bëhen simbole të lirisë, barazisë dhe emancipimit. Ka të atillë që vetëm kërkojnë nga shoqëria dhe luten që ajo t'u jap një vend dhe të tjerë që me punën e tyre e bëjnë vendin e tyre në shoqëri, dhe i japin asaj vlera shtesë, vlera që i kanë munguar. Nga këta të dytët ka qenë Halit Ferizi (të cilin një fatkeqësi komunikacioni në vitin 1974 e paralizoi për jetë), udhëheqësi faktik por do të mund të thosha edhe shpirtëror i

personave me aftësi të kufizuar cili ndërroi jetë këto ditë pas një jete plot përpjekjeje e lufte të pareshtur për dinjitet e barazi për veten dhe kolegët e tij. Kam pas nderin të punojë me të dhe ta njoh nga afër. Haliti me shokë, nuk ishte vetëm lobues i mirë kur vinte puna për të vendosur e ndryshuar ligje e politika në favor të kësaj kategorie të shoqërisë sonë, por ishte edhe shembull personal sesi me punë të vazhdueshme integroresh në shoqëri, sesi me përpjekje të pareshtura bëhesh i barabartë edhe atëherë kur ke kufizime fizike, dhe sesi ndonjëherë imponohet barazia dhe dinjiteti mu për shkak të kësaj lufte të pandalshme. Nëse gjatë punës sime në fushën e të drejtave të njeriut ka një kategori njerëzish të cilët më kanë zgjuar një admirim të posaçëm dhe që kanë

qenë e janë shembull dhe frymëzim për jetë, ata janë personat me aftësi të kufizuar. Në këtë kategori njerëzish njeriu sheh se çka është injorimi që të bën shoqëria (por edhe familja ndonjëherë) por edhe çka është dinjiteti njerëzor; çka është pabarazia por edhe si luftohet për barazi; cilat janë vështirësitë e jetës kur je i kufizuar, por edhe cili është thelbi i lumturisë kur nuk dorëzohesh, por organizohesh dhe përpjekesh për një jetë më të mirë; aty e kupton se edhe kur nuk fitohet e tërë lufta përnjëherë, duhet pasur durimin e fitimit të betejave të vogla të njëpasnjëshme, virtutet që shumë pak e gjen tek personat që nuk kanë kufizime. Haliti ka qenë shembëlltyra më e mirë e kësaj kategorie njerëzish. E ka udhëhequr këtë lëvizje me dekada, duke e shndërruar në pjesën më

aktive të shoqërisë civile dhe shpesh herë me rezultatet më të dukshme. Humbja e tij do të jetë humbje për tërë këtë komunitet njerëzish, por edhe mobilizim për të vazhduar me punë e përpjekje për të përparuar statusin e tyre në shoqëri, për të kërkuar ndihmën e shoqërisë por edhe për ta ndihmuar shoqërinë me potencialet jo të vogla që kjo kategori njerëzish ka. Dhe në këtë kategori ka vullnet për punë, intelekt, dije dhe sinqeritet. Tërë këto janë elemente që i nevojiten Kosovës tonë në këto kohë krizash të vlerave që e kanë kapluar. Bota, e aq më pak ne nuk kemi njerëz për të humbur. Haliti e ka ditur këtë më së miri. Ishte punëtor i madh andaj ju prehtë trupi në qetësi të përjetshme.

Shkruan: Valon Murati

<http://mitrovicapress.net/press/?p=4547>

Të nderuar Lexues,

Duke JU dëshiruar URATAT më të mira në Vitin e RI shfrytëzoj rastin njëherit të Uroj dhe falenderoj, Donatorët në ndihmën që ofruan për daljen e kësaj magazine festive.



Pas një kohe relativisht të gjatë, sërish jemi sëbashku me gazetën tonë të cilën mund ta lexoni në 6 gjuhë në website tonë në adresën www.lpkosova.com.

Me këtë rast dëshiroj tua refej një tregim të vjetër:

Një bartës uji kishte pasur dy enë të mëdha nga argjili të cilat të mbushura i mbante të varura në shkop mbi supe. Njëra enë ishte e dëmtuar, ndërsa tjetra ishte në rregull. Nga ena e dëmtuar uji ridhte

gjatë tërë rrugës deri në shtëpi.

Ena që ishte e padëmtuar ishte krenare me punën e sajë, ngase bartësi në shtëpi me te sillte shumë më shumë ujë, ndërkohë që ena e dëmtuar ndihej e turpëruar për këtë.

Një ditë ena e dëmtuar i tha bartësit të sajë: "Më vjen turp sepse nuk po mundem të të shërbejë ashtu siç po kam dëshirë."

Bartësi iu përgjigj: "A e ke vërejtur që lulet po lulzojnë vetëm në anën tënde të rrugës, e jo edhe në anën e enës tjetër që është në rregull? Kjo po ndodh ngase e kam ditur për mangësin tënde dhe lulet për këtë qëllim i kam mbjellur në anën tënde të rrugës. Çdo ditë ti ato lule i ke ujitur. Qe dy vite i këpus ato lule të çuditshme që më sjellin lumturi. Sikur ti mos të ishe kështu si je, këto lule nuk do të më gëzonin ditë për ditë."

Porosia:

Çdonjeri prej nesh ka mangësitë e veta. Çdonjeri prej nesh në një mënyrë është enë e dëmtuar, dhe pikërisht këto mangësi e bëjnë jetën tone më interesante dhe më të vlefshme. Na duhet përkrahja në familje dhe shoqëri që lulet në anën tone të rrugës sa më mire të lulzojnë.

Ta pranojmë vehten ashtu siç jemi dhe të bëjmë përpjekje që me gëzim të kërkojmë tek familjarët tanë, shoqëria, bashkpuntorët.... Anët pozitive.

Provoni, do të konstatooni se secili prej nesh ka diçka të vlefshme në vetvete!

Me respekt e Juaja,

Hilmnijeta Apuk,

NDIHMË FAMILJEVE TË FËMIJVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Në bazë të Ligjit mbi përkrahje materiale familjeve të fëmijve me aftësi të kufizuara, (03/L-022, od 16.05.2008 .) atyre iu takon mbështetja mujore materiale prej 100 eurosh, familjeve të fëmijve me pasoja të përhershme deri në moshën 18vjece, e pastaj atyre u takon pensioni invalidor.

Informatat mbi dokumentet e nevojshme për realizimin e kësaj të drejte në bazë të ligjit të lartë përmendur, mund të merren në Zyrat e Ministrisë për Punë dhe çështje sociale në mbarë Kosovën.

LIGJI I RI ÇDO I PESËDHJETI PUNTORË ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Eshtë miratuar Ligji për aftësimin profesional, rikualifikimin dhe punsimin e personave me aftësi të kufizuara (03/L-019, od 18.12.2008) me të cilin obligohen punëdhënësit të punsojnë një puntorë me aftësi të kufizuara në cdo të 50 puntorë të punësuar. Mirëpo, duhet të miratohet edhe Udhëzimi Administrativ dhe akte të tjera për tu aplikuar ky Ligj në praktikë.

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe institucionet tjera duhet ta kenë prioritet aplikimin e këtij Ligji, sepse me të do të zvoglohej varfëria midis personave me aftësi të kufizuara, e cila njëherit do të ndikonte në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

PËRÇINDJE MË E LARTË E PLUMBIT NË HISTORINË E MJEKSISË



Afro 200 familje, Rome e Ashkalij të shpërngulur(RAE) aktualisht të vendosur në tri kampe banimi, Osterode, Çesmin Llug dhe Kablar në pjesën veriore të Mitrovicës, e të cilat gjenden në afërsi të deponis ku janë grumbulluar 100 tonë të mbetjeve të plumbit dhe metaleve të tjera të rënda të rezikshme për jetën e njeriut. Jeta e këtyre qytetarëve të Kosovës është në rrezik të madh. Në bazë të analizave është konstatuar se në historinë e mjeksisë nuk mbahet mend të ketë ndodhur ndonjëherë të ketë dikush përqindje kaq të lartë të plumbit në gjak, mbi cdo maksimum që mund të masë ndonjë instrument i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (World Health Organization – WHO). Kjo përqindje e lartë po shkakton pasoja tepër të rënda për shëndetin dhe shumë shpesh është vdekjepruese. Në këto kampe po lindin fëmijë me përqindje të lartë të plumbit dhe metaleve tjera në gjak, e të cilat për pasojë po lënë fëmijët me të meta të përhershme psikike e fizike, atyre ju duhet mjekim urgjent dhe evakuim sa më i shpejtë nga këto kampe vdekjepruese thotë , Elizabeta Bajrami, lidere e OJQ-së Gratë Rome për Gratë Rome (Roma Women for Roma Women).



Elizabeta Bajrami

DITA NDËRKOMBETARE E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Prishtinë: 03. dhjetor 2009.

Zyra për Qeverisje të Mirë, organizoi shënimin e Ditës ndërkombtare për personat me aftësi të kufizuara në një takim me gazetarë. Kjo Konferencë, kishte për qëllim promovimin e punës që po bën Qeveria në fushën e aftësive të kufizuara, të drejtave dhe lirive si dhe mbrojtjen e dinjitetit.

Në Konferencë morrën pjesë, Michael L. Giffoni - ambasadori Italian në RK, Habit Hajredini – Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë, Antonio Organtini – Italian Cooperation, Bujar Kadriu – përfaqësues i Koalicionit të OJQ-ve dhe Afrim Maliqi nga OJQ, Hendikos i cili promovoi librin, "Të dish si" – Aftësia e Kufizuar si çështje e të drejtave të njeriut.

**Ekspozita Autentike Kulturore**

Në kuadër të kësaj Konference OJQ Little People of Kosova organizoi një Ekspozitë autentike kulturore me punime të personave me aftësi të kufizuara.

"Ne nuk dëshirojmë të mshehim dallimet tona. Përkundrazi, ne dëshirojmë të tregojmë dhe zhvillojmë simbolet tona, shenjat dhe kulturën autentike dhe në këtë mënyrë të identifikohemi më lehtë" – theksoi autorja e ekspozitës Hilmnijeta Apuk.

**Dita Ndërkombtare e të Drejtave të Njeriut**

Prishtinë: 10. dhjetor 2009.

Zyra e Kryeministrit të Kosovës, organizoi një takim me rastin e 10 dhjetorit- Ditës Ndërkombtare të të Drejtave të Njeriut, dhe njëvjetorit të miratimit të Strategjisë dhe Planit Akcional mbi të Drejtat e Njeriut (2009-2011).

Sadete Demaj në raportin e parë njëvjeçar hollësisht njoftoi mbi realizimin e Strategjisë Kombëtare dhe objektivat e Qeverisë.

**FEMIJET SHENUAN DITEN E TYRE**

OJQ Hendikep Kosova organizoi manifestimin tradicional në të cilën fëmijët me aftësi të kufizuara shënuan ditën e të drejtave të tyre.

**DR. SHYQYRI HAXHA
- Personaliteti i Vitit**

Prishtinë: 03. dhjetor 2009.

Drejtori i PTK -së, Dr. Shyqyri Haxha, morri mirnjohjen, "Haxhi Leti" për njeriun më Human të Vitit, që u nda nga koalicioni i shoqatave të të Verbërve të Kosovës.

Bujar Kadriu, Kryetar i Shoqatës në ceremonin e rastit theksoi se, PTK nën udhëheqjen e z. Shyqyri Haxha, ka bërë më shumë se çdo institucion tjetër shtetëror në lëmin e ofrit të shërbimeve, punësimit dhe promovimit të solidaritetit për personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës. Ai hapi dyert duke punësuar disa invalid me çrast shpëtoi e gëzoi familjet tona me gjendje të rënda sociale, ka theksuar, Bujar Kadriu.

Dr. Shyqyri Haxha i emocionuar, theksoi se nga mirnjohjet e shumta që ka marrë, kjo mirënjohje është privilegj dhe vlerë e veçantë për te. Ai ftoi të gjithë ata që kanë mundësi të hapin dyert për këtë kategori qytetarësh të Kosovës.



MINI OLIMPIADA

Ngjarja tradicionale dyditore sportive për personat me aftësi të kufizuara e mbajtur me 26 – 27 shtator 2009 në Akademin Policore në Vushtri e organizuar nga OJQ “OPFAKOS” përfaqsohet nga prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Në këtë ngjarje sportive morrën pjesë 573 persona, garuan 163 sportist në 8 disiplina të ndryshme: hendboll, basketboll, pikado, gjuetie, ringball për të verbër, gara në karroca, shah dhe lojra tjera për fëmijë. Fituesit u dekoruan me medalje dhe kupe për gara individuale dhe ekipore.

Donatorë ishin Akademia dhe Ministria e Kulturës.

“Mini olimpiada është një ngjarje tejet e rëndësishme për këto familje e sidomos për fëmijët ngase përmes lojës në këso aktivitete atyre iu ipet mundësia për casje të barabarta në lojë, rekreacion dhe aktivitete sportive”, theksoi Aziz Nishori nga OJQ OPFAKOS.



“ QASJE PËR TË GJITHË ”

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me datën 17.06.2007 ka nxjerr: Udhëzimin Administrativ për Kushtet e Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Me qëllim të krijimit të mundësive mbi njohjen e Udhëzimit Administrativ dhe kushtet teknike ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara si dhe sistemeve prioritare për zbatimin e këtij Udhëzimi, OJQ “Handicap Kosova” në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka mbajtur tetë takime me qytetarë nëpër disa komuna të vendit me qëllim të informimit si dhe me përfaqësues nga Insitucionet Lokale, Organizatat Joqeveritare dhe mediat lokale.



LUFTA KUNDER KANCERIT TE GJIRIT



Ambasada e SHBA, USAID, Ministria e Shëndetësisë, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë për mbrojtjen e shëndetit, Ministria e telekomunikacionit, Telemjekësia, JETA/VITA janë themelues të BCCI. Kjo nismë ka për qëllim ngritjen e vetëdijes, zbulimin e hershëm si dhe ndërgjegjësimin e institucioneve shtetërore për krijimin e kushteve elementare për trajtim të kësaj sëmundje vdekjeprurëse. BCCI ka për qëllim ti bashkoj të gjitha grate në këtë kuadër edhe ato me aftësi të kufizuara në luftë të përbashkët kundër kancerit.

Duhet vecuar aktivitetet e Qendrës së vetme Kosovare për luftimin e Kancerit të Gjirit JETA / VITA e cila që nga themelimi i saj në vitin 2005 ka aritur të sensibilizoj opinionin, të ngris vetëdijen te grate për vetëkontrolla, të ndikoj te Ministria e Shëndetësisë për krijim të kushteve më të mira për trajtim dhe luftim të kësaj pandemie.

Diana Toska, aktiviste e dalluar e të drejtave të njeriut, vullnetare dhe kryetare e bordit JETA/VITA në konferencën e organizuar më 31 tetor, Muaji i Luftës kundër Kancerit të Gjirit, në fjalën e rastit ndër të tjera tha: Ne Luftën kundër Kancerit e kemi shpallur MISION të MUNDSHEM, prandaj

poqese unifikojmë veprimet tona të gjithë së bashku mund tia arijmë këtij qëllimi kaq fisnik e human. Ajo falenderoi grate e atakuara nga kanceri, aktiviste të kësaj Qendre, duke Ju thënë se po ndihet e privilegjuar që këto gra po ia japin mundësin të gjendet në mesin e tyre dhe së bashku me to të luftoj për JETEN. Ti japim të gjithë një shansë të re JETES në KOSOVE, sepse vetëm kështu nderojmë veten dhe Humanizojmë shoqërinë kosovare.



RADIO EMISIONI “ ZËRI I ARËSYES ”

OJQ Hendikep Kosova organizon emisionin “ Zëri i arësyes ” me qëllim të senzibilizimit të opinionit public ndaj statusit të personave me aftësi të kufizuara në tema të ndryshme. Emisionin mund ta dëgjoni cdo të premte nga ora 17:00 – 17:30 në Blue Sky radio në frekvencën, 97.7 fm



“NJERËZIT MUND TË JENE TË NDRYSHEM, POR KUSHTET DUHET TI KENE TË NJEJTA ”

Me rastin e shënimit të DMD-së, Dita e mundësive të barabarta profesionale

Prishtinë: 21. tetor 2009.

Qeveria e Kosovës organizoi Konferencë me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombtare të Mundësive të Barabarta Profesionale për personat me aftësi të kufizuara e njohur në botë me emrin, Disability Mentoring Day - DMD.

Ideja ka lindë në SHBA, dhe kjo ditë që nga viti 1999, shënohet në vende të ndryshme të botës me qëllim që personat me aftësi të kufizuara, studentët apo kërkues të punës, të mund të punësohen për një ditë apo më shumë në ndonjë profesion, ku ata mund ti shprehin aftësitë e tyre punuese. Dobitë nga kjo iniciativë janë të dyfishta, ngase studentët dhe të tjerët kanë mundësi që në mënyrë direkte dhe praktike edhe të mësojnë edhe të punojnë në një vend pune, të zhvillojnë marrëdhënie afatgjata këshilldhënëse dhe njëkohësisht të përmirësojnë aftësitë e tyre profesionale. Në anën tjetër punëdhënësit, kanë mundësi të vijnë, deri te casja e punëkërkuesve, të gjejnë punëtorë sezonal, apo për afat më të gjatë, apo punsim të përhershëm dhe të shohin, më për së afërmi aftësitë profesionale të tyre.

Këto janë arësytet për të cilat, Zyra e Kryeministrit ka vendosur ti bashkangjitet shumë shteteve të botës në shënimin e kësaj dite, duke mundësuar që në disa Ministri të angazhoj, për një apo dy ditë, në punë të ndryshme studentë dhe kërkues të punës persona me aftësi të kufizuara.

Shënimin e kësaj dite në Kosovë e mundësoi OSBE – Misioni në Kosovë.



Kosovo Mental Disability
Rights Initiative

FUQIZIMI I PJESËMARRJES SË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA MENDORE NË SHOQËRINË KOSOVARE

OJQ Iniciativa Kosovare për personat me aftësi të kufizuara mendore (Kosovo Mental Disability Rights Initiatives, K- MDRI , <http://www.mdri.org/kmdri.html>) angazhohet për përmisimin e statusit dhe pjesëmarrjen më të madhe të tyre në shoqërin kosovare. Aktivitetet e kësaj organizate mbështeten nga Unioni Evropian dhe USAID.

Gjatë tetorit të vitit 2009 K-MDRI ndihmoi në punësimin e 45 personave me aftësi të kufizuara mendore, 18 nga Prishtina, 6 nga Elez Hani, 5 nga Kaçaniku, 8 nga Kamenica, 5 nga Peja dhe 3 nga Instituti në Shtime. UNDP morri përsipër ndihmën dhe përkrahjen materiale me që njëherit është edhe kompetente për Programin e tregut aktiv të punës.



Ky akcion kishte për qëllim të dëshmoj se personat me aftësi të kufizuara mendore mund të bëjnë jetë të pavarur, të punojnë dhe të jenë pjesë aktive e shoqërisë.

SFIDAT E MILENIUMIT

Prishtinë: 20. tetor 2009.


Kuvendi i RK në bashkpunim me UNDP/UNKT, organizoi konferencën dyditore në temën "Orientimi në rrugë të drejtë drejt qëllimeve të Mileniumit në Kosovë" me qëllim të diskutimit mbi progresin dhe promovimin e inkluzionit social në Kosovë.

OJQ Little People of Kosova gjatë debatit ka kërkuar kujdes më të madh të shoqëris ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe kycja më e madhe e kërkesave të tyre në qëllimet e Mileniumit. Kjo kategori e qytetarëve të Kosovës është më e varfëra dhe ka nevojë për kujdes më të madh në të gjitha sferat.



“JAVA E SHKOPIT TË BARDHË” 15 -22 tetor 2009

Shoqata e Personave të Verbër gjatë Javës Ndërkombtare të Shkopit të Bardhë organizoi defile në qendër të Prishtinës dhe mbajti një Akademi në Komunën e Prishtinës, në të cilën morrën pjesë përfaqësuesit nga Zyra e Kryeministrit dhe anëtarë nga Shoqatat e të Verbërve të Kosovës.



DITA NDËRKOMBETARE E PERSONAVE TË SHURDHER

Prishtinë: 29. shtator 2009.

Zyra për Qeverisje të mirë në bashkpunim me Këshillin për personat të shurdhër, organizoi një Konferencë me qëllim të shënimit të kësaj dite dhe informimit të opinionit me nevojat e kësaj kategorie qytetarësh. Sensibilizimi dhe edukimi i atyre që duhet marrë vendime lidhur me fatin e tyre, përmisimi i statusit nacional të gjuhës së shenjave, arsimimi, si dhe shëndetësia ishin prioritetet e kësaj konference.



KOMUNA E PRIZRENIT**Tetori i DMD-së, Muaji i mundësive profesionale**

Komuna e Prizrenit me Nënkryetarin e sajë, z.Qemail Kurtishin dhe Drita Vukshinaj nga OJQ Hendikos nga Prizreni dhe në bashkpunim me, OSBE e OJQ-të tjera të kycura në Komitetin Komunal për çështjet e personave me aftësi të kufizuara, me sukses organizuan aktivitete të shumta gjatë fushatës tradicionale, "Dhjetori DMD-së, Muaji i mundësive profesionale për personat me aftësi të kufizuara". Duhet veçuar, Konferencën për shtyp me të cilën u hap fushata, punësimi i personave me aftësi të kufizuara, brenda një dite ose gjatë disa ditëve në sektorin shoqëror apo ate privat, gjatë tërë muajit, garimi mes përdoruesve të karrocave, foto ekspozita, seminari në të cilën u prezentuan, Plani Nacional, akcioni me Policin e Komunikacionit për shënimin e parkingjeve, turniri në basketboll për personat në karrocë. Ndërsa duhet veçuar edhe rastin e Miradije Berishës, anëtare e Hendikosit e cila u punësua në vend të regullt të punës.

Në fund të fushatës u organizua një puntori me qëllim të marrjes së vendimeve të cilat do të ndikojnë në përmisimin e statusit të personave me aftësi të kufizuara, si shkurtimi i orarit të punës, çasje më e madhe në punësim, ndërtimi i infrastrukturës për çasje më të lehtë për përdoruesit e karrocave, një përkthyes për shurdhmemecët, pacientët në Qendrën Familjare Mjekësore në Prizren, lirim nga tatimi komunal për pronarët e firmave private me aftësi të kufizuara.



Qemail Kurtishi,
Nënkryetar i Komunës së Prizrenit

**OJQ "HENDIFER" FERIZAJ**

Prodhimi dhe riparimi i mjeteve ndihmëse

Programi prodhues i puntorisë Ortopedike – Hendifer, Ferizaj është i vetmi në Kosovë. Specifikë e saj është jo vetëm prodhimi por riparimi i karrocave, rampave mobile dhe mjeteve të tjera ndihmëse ortopedike, dhe të gjitha këto bëhen në bazë të kërkesave dhe nevojave personale.

"Shfrytëzoj rastin të apeloj lexues të nderuar deri tek ju që mos ti hudhni karrocën, por ato ti sillni tek ne në riparim" – porositi Fazile Bungu, menaxheri e puntorisë, "Ortopedia-Hendifer" në Ferizaj.

Ministria e Shëndetësisë do të duhej ta përkrahte këtë iniciativë private e aq humane së paku me një donacion për krijimin e kushteve elementare për punë, me që sigurimi i karrocave është në kompetencën të sajë.

Të Drejtat e Njeriut

OJQ Hendifer merr pjesë aktive në fushatat

informative që kanë për qëllim sensibilizimin e opinionit lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në programin vullnetar multi-etnik DMD (Disability Mentoring Days).

Lufta kundër Izolimit

OJQ "Hendifer" nga Ferizaj në mënyrë vullnetare ofron shërbime për persona me aftësi të kufizuara, e sidomos për të moshuarit e vetmuar pa kurcuar mbështetje shoqërore. Këto aktivitete humane, gjithmonë përkrahen nga nxënësit e shkollës së mesme të mjeksisë dhe Qendrës Familjare.

Gjatë vitit 2009 Hendiferi organizoi dy pikniqe rekreative për 150 persona me aftësi të kufizuara, të cilët patën mundësinë të shijojnë bukurinë e natyrës dhe zhvillojnë aktivitete sportive.

Festimi i festave të fundvitit

Hendifer për festat e Vitit të RI me dhurata dhe program artistik gëzoi mbi 200 fëmijë me aftësi të kufizuara.

**Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës**

Prishtinë: 03 tetor 2009.

Me një ceremoni rasti u lëshua në përdorim autobusi special me ashensor, dedikuar udhëtarëve me karrocë, për fëmijë e të ritur që kanë vështësi në të ecur dhe për atë kategori të udhëtarëve të moshuar që kanë nevojë për përcjellje deri në hyrje të aeroplanit. Aeroporti ndërkombëtarë i Prishtinës me këtë projekt, mundësoi casje të barabartë për të gjithë udhtarët në komunikacionin ajror pa diskriminim, njëherit krijoi kushte për liri të lëvizjes për këta persona në nevojë.

**OJQ Down Syndrome Kosova – DSK**

OJQ DSK u themelua më 04. mars 2007, nga prindërit e fëmijëve me Down Syndrom. Kjo organizatë është mjaft aktive dhe lufton për inkudrimin në shoqëri të të gjithë atyre që janë të prekur me Down Syndrom.

Më shumë mbi ta dhe aktivitetet e tyre mund të mësoni në websit

www.downsyndromekosova.org


Mund të kontaktoni në - tel/ fax: 038 545715; 044 112170; 044 185685; e-mail: info@downsyndromekosova.org, Adresa: Rr. Kroj i Bardh Nr. 72, Dardania, 10000 Prishtina

**TALENTET ME AFTESI TE KUFIZUARA**

www.webbytalents.com

Njoftojmë personat e talentuar me aftësi të kufizuara të lajmrohen në web – faqen www.webbytalents.com dhe të paraqesin punimet e tyre.

Ky website është një platformë e mirë ku personat e talentuar mund të dëshmojnë aftësitë e tyre krijuese, të zhvillojnë kulturën e tyre autentike dhe krijojnë një botë më të mirë për të gjithë.



Autor: Hiljinnijeta Apuk,



2010



January 2010

Su	Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30
31						

February 2010

Su	Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28						

March 2010

Su	Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			

April 2010

Su	Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	

May 2010

Su	Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					

June 2010

Su	Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30			

July 2010

Su	Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31

August 2010

Su	Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

September 2010

Su	Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30		

October 2010

Su	Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30
31						


November 2010

Su	Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30				

December 2010

Su	Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31

Donatori:



www.lpkosova.com